



**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE
KONTROLLIT TË PASURIVE**

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN E SHORTIT NË
PËRZGJEDHJEN
E DEKLARATAVE TË ZYRTARËVE QË DO T'I
NËNSHTROHEN KONTROLLIT TË PLOTË**

Neni 1
Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është Ligji Nr.9367, datë 07.04.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, neni 17 pika 3 e tij si dhe Ligji Nr.9049, datë 10.04.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*.

Neni 2
Objekti

Rregullorja për organizimin e hedhjes së shortit (në vijim *“rregullorja”*) përcakton rregullat dhe procedurat që do të ndiqen nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) në përzgjedhjen e deklaratave të subjekteve ndaj të cilëve do të ushtrohet kontroll i plotë në zbatim të nenit 17, pika 3 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Neni 3
Qëllimi

Rregullorja ka si qëllim të përcaktojë metodikën e funksionimit të procedurës së hedhjes së shortit; të sigurojë rregulla dhe standarte të përcaktuara qartë për zhvillimin e kësaj procedure, me pjesëmarrjen aktive të publikut, përfaqësuesve të medias, përfaqësuesve të grupeve parlamentare, shoqërisë civile, duke garantuar transparencë dhe paanshmëri në procedurën e hedhjes së shortit.

Neni 4
Subjektet e shortit

1. Përzgjedhja me short për kontrollin e plotë të deklaratave të interesave private periodike të të gjithë kategorive të zyrtarëve, realizohet për një numër prej 4 % të numrit të përgjithshëm të deklaratave.
2. Në përfundim të afatit ligjor të dorëzimit të deklaratave të interesave private të zyrtarëve, subjekte deklarues në ILDKP, Sektori i Protokoll-Arkivës në bashkëpunim me Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse, nxjerr listën e plotë të subjekteve që do i nënshtrohen procedurës së përzgjedhjes me short të zyrtarëve për kalimin në kontroll të plotë.
3. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e zyrtarëve që do të kalojnë në kontroll të plotë bëhet në prani të sindikatave, të grupeve të ndryshme të zyrtarëve, të medias, të shoqërisë civile dhe të përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Neni 5
Rregullat e organizimit dhe mbikqyrjes së shortit

1. Numri i zyrtarëve që do të përfshihen në procesin e përzgjedhjes me short për kalim në kontroll të plotë, përcaktohet në bazë të listës së zyrtarëve që i nënshtrohen deklaramit periodik (*para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni*) për periudhën kohore nga data e zhvillimit të shortit pararendës deri një ditë përpara hedhjes së shortit përkatës.
2. Lista e subjekteve që do të përfshihen në short gjenerohet nga Rregjistri Themeltar i ILDKP (*excel*). Renditja e emrave të

zyrtarëve në listë do të jetë sipas renditjes së tyre ekzistuese në bazë të numrit të indeksit (numri identifikues i subjektit) në Regjistrin Themeltar. Mbi bazën e kësaj renditje, bëhet numërimi i listës së subjekteve duke filluar nga numri 1.

Lista e subjekteve që do të përfshihen në short, do të jetë në formë tabelare, në variantin excel, dhe do të përmbajë për çdo subjekt, *Numrin rendor, Numrin e indeksit, Emrin, Atësinë, Mbiemrin, Institucionin, Funkcionin.*

Kjo listë do të shfaqet për të pranishmit në ekran gjatë gjithë procedurës së shortit. Gjithashtu në dispozicion të të pranishmëve do të jetë një kopje e printuar e listës së subjekteve.

3. Përzgjedhja e zyrtarëve që do të përfshihen në short do të bëhet sipas përzgjedhjes elektronike rastësore (*random*) dhe do të realizohet me pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të shoqërisë civile, medias, publikut, përfaqësuesve të sindikatave etj.
4. Me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm caktohet Komisioni i Shortit, që do të jetë përgjegjës për ecurinë dhe dokumentimin e procesit të hedhjes së shortit elektronik.

Neni 6

Detyrat e Komisionit të Shortit

1. Për organizimin dhe mbarëvajtjen e procedurës së hedhjes së shortit, Inspektori i Përgjithshëm cakton një Komision të përbërë nga 5 anëtarë.
2. Komisioni është përgjegjës për zhvillimin dhe dokumentimin e procedurës së hedhjes së shortit.
3. Përpara fillimit të procedurës së përzgjedhjes me short, një nga anëtarët e Komisionit, sqaron procedurën e shortit për pjesëmarrësit dhe deklaron publikisht numrin e subjekteve

që do të kalojë në kontroll të plotë, sipas llogaritjes matematikore të 4% të numrit të përgjithshëm të subjekteve që i nënshtrohen deklarimit periodik të interesave private, sipas formulës: numri i përgjithshëm X zyrtarë/deklarata (numri i përgjithshëm) x 4% = Y numri i deklaratave që kalojnë në kontroll të plotë.

4. Komisioni i Shortit është përgjegjës për dokumentimin e plotë të procedurës së ndjekur dhe rezultateve të shortit, në përfundim të së cilës hartojnë procesverbalin përkatës, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij.

Neni 7

Rregullat e procedurës elektronike të shortit

1. Procedura e zhvillimit të shortit do të jetë elektronike dhe do të pasqyrohet drejtpërdrejt për pjesëmarrësit prezent në sallë, në një ekran me përmasa 58".
Për këtë arsye, shpërndarja e numrit të përgjithshëm të zyrtarëve të përfshirë në procesin e përzgjedhjes me short, në sistemin elektronik, do të organizohet në 10 nëndarje të emërtuara me shkronjat: A, B, C, D, E, F, G, H, I, J.
2. Në rastin kur numri i përgjithshëm i subjekteve është i plotpjestueshëm me 10, çdo nëndarje do të ketë një shpërndarje të barabartë të numrit të zyrtarëve të përfshirë në short, në formën e kutive/qelizave. Kur numri i përgjithshëm i subjekteve nuk është i plotpjestueshëm me 10, do të shtohet një nëndarje e re, në varësi të numrit që ka mbetur.
3. Çdo kutie/qelize i korrespondon numri rendor i një subjekti deklarues.
4. Renditja fillestare e numrave në grupe është sipas progresionit rritës, duke filluar nga numri 1 e deri në numrin

që i korresponдон numrit të përgjithshëm të zyrtarëve të përfshirë në short.

5. Kjo renditje do i demonstrohet të pranishmëve, përpara se të fillojë procesi i përzgjedhjes së numrave.

Neni 8

Përzierja rastësore e numrave

1. Në menunë kryesore të sistemit elektronik shfaqet butoni “PËRZIEJ NUMRAT”. Përmes klikimit të këtij butoni nga përzgjedhësi/it nga salla, përjashtuar punonjësit e ILDKP, bëhet përzierja elektronike rastësore (*random*) e të gjithë numrave nëpër nënndarjet/grupet e shfaqura në ekran.
2. Procesi i përzierjes së numrave mund të përsëritet disa herë në varësi të interesit të pjesëmarrësve, para fillimit të procesit përzgjedhjes. Pas fillimit të procedurës së shortit dhe përzgjedhjes së numrave/qelizave, procesi i përzierjes është i paaplikueshëm nga sistemi, me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së tij.

Neni 9

Përzgjedhja e numrave

1. Cilido nga përfaqësuesit e medias, shoqërisë civile, publikut, përfaqësuesve të sindikatave, përfaqësuesve të grupeve parlamentare pjesëmarrës në këtë proces ftohen të marrin pjesë në përzgjedhje.
2. Përzgjedhësi ka të drejtë të klikojë në nënndarjen/grupin ku ai dëshiron të bëjë përzgjedhjen e tij. Pas përzgjedhjes së një nënndarje, në ekran do të shfaqet tabela me qeliza, ku çdo qelizë është e shënuar me simbolin e pikëpyetjes ?. Pas

çdo qelize gjendet një numër rendor që i korrespondon një subjekti deklarues.

3. Klikimi mbi qelizë bën të mundur hapjen e një numri dhe shfaqjen e të dhënave të plota të subjektit të përzgjedhur. Të dhënat si numri rendor, emri, atësia, mbiemri, funksioni dhe institucioni, shfaqen në krye të faqes.
4. Për çdo rast përzgjedhje nga pjesëmarrësit nga salla, do të bëhet vetëm një herë rradhazi. Janë të përjashtuar nga procesi përzgjedhës punonjësit e ILDKP.
5. Përzgjedhja e një qelize bën automatikisht kalimin e subjektit që i përkon asaj qelize, në listën përfundimtare të subjekteve që do të kalojnë në kontroll të plotë, e cila do të jetë e afishuar në një ekran paralel.
6. Përmes butonit "TABELA KRYESORE", përzgjedhësi ka mundësinë të rikthehet në mënyrë kryesore për të zgjedhur në një nëndarje tjetër, të ndryshëm nga i pari.
7. Përzgjedhja do të vijojë në këtë mënyrë deri me plotësimin e 4% të numrit të përgjithshëm të deklaratave.

Neni 10

Dokumentimi i procedurës së ndjekur

1. Përzgjedhja e subjekteve deklarues dhe shfaqja e të dhënave të tyre në krye të faqes, njëkohësisht do të shoqërohet dhe me një demonstrim paralel në ekranin tjetër ku është e shfaqur lista e subjekteve të përfshirë në short sipas Rregjistrimit Themeltar i ILDKP.
2. Anëtarët e Komisionit do të bëjnë verifikimin e numrave të përzgjedhur me emrat korrespondues të subjekteve deklarues, si dhe regjistrimin e tyre në listën përfundimtare.
3. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes së numrave mbahet procesverbali ku pasqyrohet procedura e ndjekur,

numri i përgjithshëm i deklaratave të përfshira në short, numri i deklaratave të përzgjedhura si dhe i bashkëlidhet lista e zyrtarëve të përzgjedhur nga shorti.

4. Përmbajtja e secilës nëndarje, të përbërë prej grupimeve tabelare në sistemin elektronik në formën e kutive/qelizave, që vërteton përfshirjen në short të të gjithë subjekteve deklarues, do të printohet dhe vihet në dispozicion të të interesuarve, menjëherë pas përfundimit të procedurës së shortit.
5. Lista e zyrtarëve të përfshirë në procedurën e përzgjedhjes me short, lista e zyrtarëve të përzgjedhur nga shorti, procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Shortit dhe Listat e zyrtarëve të secilit grup sipas nëndarjeve në sistemin elektronik, do të depozitohen në Zyrën e Protokoll-Arkivës.

Neni 11

Rezultatet e shortit dhe publikimi

1. Lista emërore e zyrtarëve që kalojnë në kontroll të plotë për shkak të shortit, do të shpallet në përfundim të procesit të përzgjedhjes, do të bëhet publike në media, si dhe do të pasqyrohet në faqen e internetit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
2. Me përfundimin e procedurës së shortit, lista emërore e zyrtarëve që do të kalojnë në kontroll të plotë, do të printohet dhe shpërndahet për të pranishmit.
3. Lista e zyrtarëve të përzgjedhur me short, i paraqitet Inspektorit të Përgjithshëm për të nxjerrë urdhrin për fillimin e procedurës të kontrollit të plotë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Adriatik LLALLA